

"Mësues është ai që posedon çelesin me ndihmën e të cilit edhe ti behesh Mësues... te ju ndihmon ta kuptoni se edhe ju jeni Mësues, që ju dhe Zoti të jeni një. Kjo është krejt... dhe ky është i vetmi rol i Mësueses.."

~ Mësuesja Superiore Ching Hai ~

"Rruga jonë nuk është religjioni. Unë askënd nuk e kthej në katolicizëm, budizëm ose në ndonjë 'izam' tjetër. Unë thjeshtë ju ofroj rrugën deri te vetëvetja; që ti zbuloni mësheftësit e gjithësis; ta kuptoni pse këtu egziston aq mjerimi, e të jeni njohur se çfarë na pret pas vdekjes."

~ Mësuesja Superiore Ching Hai ~

"Jemi të ndarë prej Zotit sepse jemi shumë të preokupuar. Nëse ndokush ju fletë e ndër kohë pa ndërprer xingërron telefoni, nëse diçka zijeni apo bisedoni, atëherë askush nuk mund të ju afrohet. E njëjëta gjë ndodh edhe me Zotin. Ai thirrë gjdo ditë, a ne nuk kemi kohë për Atë dhe e lëjmë sikur telefonin duke xingruar."

~ Mësuesja Superiore Ching Hai ~

Biografi e shkurtër e Mësueses Ching Hai

Mësuesja Ching Hai është lindur në një familje të pasur në Aulacu (Vijetnam), si vajzë e mjekut i cili ka përdorur metoda natyrore për mjekim. Është edukuar në frymë të katolicizmit, e prej gjyshës i ka fituar qëndrimet themelore të budizmit. Shumë herët, si fëmijë, ka pasur interesim për filozofi dhe mësimet religjioze dhe kishte marrëdhënje të nderëshme mes krijesave të gjalla.

Pasi që i mbushi 18 vjet Mësuesja Ching Hai shkoi në studime në Angli, më vonë shkoi në Gjermani dhe në Francë, ku punoi në Kryqë të Kuq, e u martua me shkencëtar gjermanë. Pas dy viteve të lumtura martesore u nda prej bashkëshortit me pajtim të tij, për të vazhduar gjurmimin e shëndritjes, kështu që ja arriti idealit të cilin e kërkonte prej fëmijërisë. Në atë kohë u muarr me shumë metoda të meditimit dhe disiplinë spirituale nën udhëheqjen e mësuesit dhe mjeshtrit që ishte i arritshëm për të. Së fundi e kuptoi se është e pa kuptim që si person i vetëm të ndihmojë për zbutjen e vuajtjes së njerëzimit, e kuptoj se mënyra më e mirë për të ju ndihmuar njerëzve që vetë të arrij shkallë të plotë të vetëdijes. Vetëm me atë vizion ajo ka udhëtuar në vende të ndryshme dhe ka gjurmuar metodën më të plotë të vetëdijes.

Pas shumë viteve, të mbushura me provime, me përvojë dhe pas shumë problemeve dhe mjerimeve Mësuesja Ching Hai së fundi në

Himalaje gjeti metodën Quan Yin dhe përcjelljen Madhështore. Deri sa jetonte në Himalaje, disa vite me rradh ushtroi dhe arriti ndriçim të plotë.

Disa vite pas ndriçimit Mësuesja Ching Hai jetoi një jetë të qetë dhe të tërhekur si murgeshë budiste. Nga natyra ishte e turpëshme, ajo këtë pasuri e ruajti në vehte, deri sa nuk filluan ti vinin njerëzit, të cilët e shprehnin dëshirën që ajo ti mëson dhe ti udhëzon në mësimet e saja. Lutjet e tyre dhe përpjekjet e nxënësve të parë në Formosi (Tajvan) dhe në USA janë shkak që Mësuesja filloj ti mbajë ligjeratat nëpër botë, dhe me mësimet e saja udhëzoi mijëra e mijëra njerëz të ndershëm, të cilët dëshironin të kenë zhvillim spiritual.

Sot një numër i madhë i njerëzve, të cilët kërkojnë të Vërtetën, pra njerëz të religjioneve të ndryshme dhe vendeve të ndryshëm, vijnë tek ajo për ta njohur urtësinë e saj të madhe. Mësuesja ka dëshirë ti mësoj njerëzit, të cilët janë të gatshëm të mësojnë dhe sinqerisht ta praktikojnë metodën e drejtëpërdrejt të ndriçimit, të cilën ajo e vërtetoj si më të lartë, metodën Quan Hin, duke i udhëhequr në rrugën e tyre spirituale.